

# SFIDAT ME TË CILAT PËRBALLET ARSIMI I LARTË NË SHQIPËRI.

Albana Kosovrast<sup>1</sup> Edlira Kola<sup>2</sup>

<sup>12</sup> Departamenti i Gjeografisë, UT.

## Abstract

Cështjet kryesore që do të trajtohen në këtë kumtesë janë:

- A. *Historia e krijimi të arsimit të lartë në Shqipëri dhe karakteristikat kryesore të tij deri në vitin 1990.*
- B. *Ndryshimet që ndodhën në arsimin e lartë në Shqipëri pas viteve 1990.*
- C. *Sfidat me të cilat përballlet sot arsimit të lartë në Shqipëri.*

1. *Historia e krijimi të arsimit të lartë në Shqipëri dhe karakteristikat kryesore të tij deri në vitin 1990.*

Arsimi i lartë në Shqipëri e ka zanafillën në vitin 1946, me Institutin 2-vjeçar Pedagogjik të Tiranës. Universiteti i parë në vend është ai i Tiranës, i cili u hap në vitin 1957, duke u mbështetur në traditën e mirë të krijuar nga institutet që funksiononin deri në atë kohë në Tiranë: instituti pedagogjik, politeknik, ekonomik, mjekësor, juridik dhe instituti i shkencave. Deri në këtë periudhë arsimimi i lartë kryhej vetëm jashtë vendit kryesisht në Itali, Francë, Rumani etj. Pas vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri, këta intelektualë të arsimuar jashtë vendit u përndoqën nga regjimi. Shteti në fuqi i kushtoi vëmendje të rëndësishme përgatitjes së kuadrove të rinj, që vinin kryesisht nga klasa punëtore dhe fshatarsia. Numri i studentëve dhe i pedagogëve erdhi duke u rritur nga viti në vit. U rrit numri i studentëve femra, gjë që ndikoi pozitivisht në emancipimin e mëtejshëm të femrës në Shqipëri. Sistemi arsimor universitar gjatë kësaj periudhe kishte baza thellësisht ideologjike. Përzgjedhja e lëndëve dhe programeve ishte e centralizuar dhe bazuar në një filozofi të qartë pedagogjike, që ishte mësimdhënia e cila synonte përgatitjen e një brezi profesionistësh me detyra të qarta shoqërore. Universitetet shqiptare të periudhës komuniste ishin kryesisht qendra mësimdhënieje dhe jo projektesh studimore. Gjithashtu, shpërndarja e të drejtave të studimit dhe fituesit e tyre ishin të kontrolluar nga regjimi totalitar komunist. Por, ishin këto institucione universitare dhe studentët që kuptuan nevojën e ndryshimeve dhe u vunë në krye të lëvizjes që sollën ndryshime rrënjësore për Shqipërinë.

2. *Ndryshimet që ndodhën në arsimin e lartë në Shqipëri pas viteve 1990.*

Disa nga ndryshimet që do të trajtohen janë:

- a. Dhënia e statusit të universitetit instituteve që funksiononin deri në këtë kohë në Shqipëri si Istituti Bujqësor i Kamzës, Istituti i Shkodrës, Instituti i Elbasanit etj. që kishin luajtur një rol të rëndësishëm në formimin e profesionistëve të fushave të ndryshme.
- b. Vendosja e sistemit të konkursit në rekrutimin e studentëve në universitete.
- c. Rritja e numrit të studentëve dhe i pedagogëve në vite.

- d. Hartimi i kurrikulave të reja në përputhje me Kartën e Bolonjës që përmirësonin cilësinë në universitete.
- e. Krijimi i universiteteve private, një risi për arsimin e lartë në Shqipëri.

**3. Sfidat me të cilat përballlet sot arsimit i lartë në Shqipëri.**

Këtu do të trajtohen:

- a. problematikat me të cilat përballlet arsimit i lartë në Shqipëri dhe
- b. do të japim disa sugjerime për zgjidhjen e disa prej tyre si psh.
  1. Matura shtetërore, aspektet positive dhe negative të saj, në rekrutimin e studentëve në universitete.
  2. Universitetet private dhe roli i tyre në arsimin e lartë në Shqipëri.
  3. Universitetet shtetërore si institucionet më të preferuara dhe me numrin më të lartë të studentëve. Cfarë i bën ato më të kërkuarat cilësia apo cmimet e ulëta ?
  4. A nevojiten ndryshime të thella në strukturat dhe kurrikulat e universiteteve tona?
  5. Numri i lartë në rritje i studentëve është pozitive apo negative për vendin tonë ?

University of Shkodra “Luigj Gurakuqi”, Shkodra, Albania